



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI**

Nr. 8000/1 Prot. Tiranë, më 20.08. 2019

**MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË
MINISTRI**

Nr. 15302/4 Prot. Tiranë, më 28. 8. 2019

U DHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 18, datë 20.08. 2019

PËR VITIN SHKOLLOR 2019–2020 NË SISTEMIN ARSIMOR PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

U DHËZ O J M Ë:

KREU I VEPRIMTARIA NË INSTITUCIONET ARSIMORE

I.I. ARSIMI PARASHKOLLOR

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (DRAP apo ZVAP) dhe drejtuesit e kopshteve publike, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore, të ndjekin me përparsi:

1. Zbatimin e kurrikulës së arsimit parashkollor bazuar në kornizën kurrikulare të arsimit parashkollor, në standarde zhvillimit dhe të nxënët përfmijët 3-6 vjeç dhe në programet e arsimit parashkollor për çdo grup.
2. Regjistrimin në klasën përgatitore (grupi i tretë) të fëmijëve 5-vjeçarë që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin.
3. Regjistrimin në kopsht të fëmijëve me nevoja të veçanta (nga familjet në nevojë, romë, egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara).
4. Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve përfmijët me aftësi të kufizuara, në kopshte ku ka fëmijë të tillë.

5. Caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato kopshte ku ka fëmijë të tillë, sipas rekomandimit të dhënë nga komisioni multidisiplinar në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, bazuar në portalin “Mësues për Shqipërinë”.
6. Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollar në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara.
7. Pajisjen e fëmijëve që përfundojnë të paktën njërin nga tri grupet dhe kanë moshën për të ndjekur klasën e parë, me vërtetimin e ndjekjes së kopshtit për grupin përkatës, të nënshkruar nga drejtuesi i kopshtit.
8. Ngritjen në çdo kopsht të bordit, këshillit të prindërve, këshillit të mësuesve dhe komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjisacionit në fuqi.
9. Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe rrjetet profesionale, të temave të mëposhtme:
 - a) standardet e zhvillimit dhe të nxënësit të fëmijëve 3-6 vjeç, miratuar me urdhrin nr.8, datë 12.1.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - b) kurrikula me kompetenca e arsimit parashkollar, miratuar me urdhrin nr.8, datë 12.1.2017, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
 - c) planifikimi sipas kurrikulës së re;
 - d) portofoli i të nxënësit;
 - e) vlerësimi i fëmijëve.
 - f) standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesit të arsimit parashkollar, miratuar me shkresën nr.9303/1prot., datë 20.9.2018.
 - g) bashkëpunimi me prindërit e fëmijëve me qëllim që veprimtaritë që zhvillohen në kopsht dhe në shtëpi, të plotësojnë dhe të përforcojnë njëra-tjetrën.

I.2. ARSIMI BAZË

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar (DRAP apo ZVAP) të ndjekin me përparësi zbatimin e planeve mësimore të arsimit bazë, sipas pikës 1, të shtojcës bashkëlidhur, si dhe:
 - a) Zbatimin e kurrikulës së re në të gjitha klasat (I-IX), bazuar në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në arsimin fillor (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin fillor IZHA, prill, 2018), në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin e mesëm të ulët IZHA, janar, 2017), udhëzuesin kurrikular lëndorë në arsimin e mesëm të ulët (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin e mesëm të ulët sipas profileve përkatëse, IZHA, 2018).
 - b) Përdorimin e portofoleve lëndore për klasat 6, 7, 8 dhe 9, për lëndët shoqërore dhe natyrore për vlerësimin e nxënësit, bazuar në udhëzimin nr.34, datë 11.9.2015, “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulen me kompetenca, në arsimin bazë”, si dhe në materialin shpjegues për vlerësimin e nxënësit në arsimin e mesëm të ulët, (IZHA, 2018).
 - c) Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara.
 - d) Caktimin e mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, në ato shkolla ku ka fëmijë të tillë, sipas rekomandimit të dhënë nga komisioni multidisiplinar në njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, bazuar në udhëzimin nr.13, datë 22.5.2019, “Për

procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë””.

- e) Pjesëmarrjen aktive të përfaqësuesve të tyre në njësitë për mbrojtjen e fëmijëve, të ngritura në nivel bashkie.
- f) Plotësimin e nevojave dhe kërkesave për arsimim në gjuhën amtare të pakicave kombëtare, në përputhje me konventën përkatëse dhe legjislacionin e BE-së.
- g) Regjistrimin me përparësi në shkollë të fëmijëve nga shtresat në nevojë, romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara, të kthyer nga emigracioni si dhe të fëmijëve viktima apo viktima të mundshme të trafikut të qenieve njerëzore.
- h) Zbatimin e pikës 11, të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Romët dhe zgjerimin e tyre në BE, nga fjalët në veprime, nënshkruar nga kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, institucionet arsimore të angazhohen për rritjen e shkailës së përfundimit prej tyre të arsimit bazë në masën 90 për qind.
- i) Krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse për zbatimin e kurrikulës së re.
- j) Krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve të klasave kolektive.
- k) Krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës.
- l) Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe rrjetet profesionale të praktikave dhe rasteve të suksesit në arsimimin me cilësi të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- m) Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, në shkollat e arsimit bazë (jospeciale), sipas rekomandimit të komisionit multidisiplinair të institacioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në bashkëpunim me prindërit e fëmijëve, psikologë, punonjës socialë, profesionistë nga strukturat e shëndetësisë dhe të shërbimeve sociale të specializuara.
- n) Organizimin e përkujdesjes së posaçme për nxënësit me vështirësi në të nxënë.
- o) Sigurimin e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme.
- p) Koordinimin dhe realizimin e veprimit tarive për mbrojtjen e fëmijëve në internet.
- q) Koordinimin dhe realizimin e veprimit tarive ne kuadrin e realizimit të projektit *e-twinning*, mbështetur në Marrëveshjen e MASR për periudhën 2019-2020.
- r) Konsolidimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.
- s) Planifikimin e veprimit tarive të veçanta për institucionet publike të arsimit parauniversitar ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare, me qëllim ruajtjen e promovimin e trashëgimisë kulturore dhe artistike të pakicave kombëtare.
- t) Ndjekjen me përparësi nga drejtuesit e shkollave të arsimit bazë të:
 - i. bashkëpunimit me bordin, këshillin e prindërve të shkollës dhe klasës, qeverinë e nxënësve, njësinë vendore për mbrojtjen e fëmijës dhe me organizata joftimprurëse;
 - ii. ngritjes dhe funksionimit të komisioneve multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara (AK), në ato shkolla ku ka fëmijë me AK, bazuar në Dispozitat Normative Për Sistemin Arsimor Parauniversitar 2013, të ndryshuara(në vijim DN 2013, të ndryshuara);
 - iii. regjistrimit të nxënësve që i përkasin zonës së shkollës, si dhe ruajtjen e një numri të balancuar të nxënësve për klasë mes shkollave të një zone, bazuar në udhëzimin nr.30, datë 12.9.2018, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”;

- iv. regjistrimit me përparësi të fëmijëve sipas përcaktimit të shkronjës “g”, të pikës 1, më sipër.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave të ndjekin me përparësi mësimin e gjuhëve të huaja në arsimin bazë:
- a) **Në arsimin fillor**
- Mësimi i gjuhës së huaj të parë fillon në klasën III dhe ZVAP-të në bashkëpunim me drejtoritë e shkollave të respektojnë parimin e shumëgjuhësisë sipas angazhimeve dypalëshe dhe nevojave të përcaktuara nga vetë shkollat. Planifikimi të realizohet duke pasur parasysh stafin mësimdhënës dhe strukturën e shkollës. Nuk planifikohet gjuhë e huaj e dytë për klasat III, IV dhe V të arsimit fillor.
- b) **Për nxënësit që nuk kanë zhvilluar gjuhë të huaja**
- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave të sigurojnë zhvillimin e gjuhës së huaj në të dy ciklet, si dhe për nxënësit e klasës IX të sigurohet mësimi i gjuhës së huaj, në mënyrë që nxënësit të jenë të përgatitur për provimin e gjuhës së huaj në provimet kombëtare të arsimit bazë 2020.
- c) **Për sigurimin e vijimësisë së gjuhës së huaj**
- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave të sigurojnë vijimësinë e gjuhës së huaj të parë, të nisur në klasën III të arsimit fillor, dhe të gjuhës së huaj të dytë, të nisur në klasën VI, pavarësisht planit mësimor me të cilin punohet. Edhe në rastet e transferimeve, të ruhet vijimësia e gjuhës së huaj të parë dhe të dytë nga arsimi bazë në arsimin e mesëm të lartë dhe atë profesional.
- d) **Për zbatimin e memorandumeve dhe marrëveshjeve dypalëshe**
- Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të vijojnë zbatimin e marrëveshjeve dhe memorandumeve si vijon:
- për gjuhën italiane, vijon zbatimi i Memorandumit të Mirëkuptimit për programin “Iliria”. Planifikimi i shkollave që do të zhvillojnë gjuhën italiane, është kompetencë dhe përgjegjësi e institacioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar;
 - për gjuhën frënge, vijon zbatimi i angazhimeve në kuadër të aderimit në Organizatën Botërore të Frankofonisë, duke mundësuar që 30% e nxënësve që mësojnë gjuhë të huaj, të mësojnë gjuhën frënge si gjuhë të huaj të parë nga klasa III e arsimit fillor dhe gjuhë të huaj të dytë nga klasa VI e arsimit të mesëm të ulët deri në klasën XII të arsimit të mesëm të lartë;
 - ZVAP Elbasan, Durrës, Korçë, Shkodër dhe Tiranë, në shkollat e të cilave funksionojnë klasat mbështetëse për seksionet dygjuhëshe shqiptaro-italiane, shqiptaro-franceze dhe shqiptaro-gjermane të sigurojnë hapjen e klasave në shkollat e përcaktuara në memorandume, duke filluar në klasën III të arsimit fillor dhe në klasën VI të arsimit të mesëm të ulët përfazë tranzitore;
 - brenda datës 30 shtator 2019, ZVAP-të të raportojnë në Drejtorin e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) planifikimin për secilën gjuhë të huaj dhe realizimin e detyrave të

mësipërme dhe DPAP-ja njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (në vijim DPPZHASR) nëse ka problematika.

3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në përputhje me urdhrin nr.811, datë 14.12.2018, “Për Miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, të ndjekin zbatimin në shkollat e planifikuara prej tyre.
4. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në përputhje me urdhrin nr.85, datë 15.2.2019 për “Për realizimin e Planit të aktiviteteve në kuadër të programit *e-twinning*, për vitin 2019-2020, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes”, të ndjekin zbatimin në shkollat e planifikuara prej tyre.
5. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar që kanë shkolla ku zbatohet projekti “Mësime të shahut në shkollë”, të marrin masa për plotësimin e angazhimeve, në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis MASR-së, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut.
6. Në zbatim të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MASR-së dhe UNFPA-s, të vlerësohet programi “Edukimi shëndetësor me fokus aftësitë për jetën dhe edukimin seksual”. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoret e shkollave të arsimit bazë të lehtësojnë procesin e trajnimit të mësuesve të arsimit fillor dhe të lëndëve “Biologji”, “Edukim qytetar”, “Edukim fizik, sporte dhe shëndet”.
7. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, bazuar në urdhrin nr. 440, datë 25.7.2018 “Për hapjen e klasave të profilizuara në sport në institucionet arsimore të arsimit bazë të sistemit arsimor parauniversitar”, për hapjen e klasave të profilizuara në sport, të ndjekin procedurat në vijim:
 - a) Klasa e profilizuar në sport krijohet në disiplinat sportive futboll, basketball dhe volejboll. Për raste të veçanta, me kërkesë të institacioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe miratimin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, mund të hapen klasa të profilizuara në sport edhe për disiplina të tjera sportive.
 - b) Drejtuesit e institacioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe/ose drejtoret e shkollave 9-vjeçare vendosin për hapjen e klasës së profilizuar në sport, vetëm nëse shkolla plotëson kushtet e infrastrukturës dhe kriteret e mësimdhënies së personelit të edukimit fizik.
 - c) Krijimi i klasës së profilizuar në sport, referuar elementëve bazë teknikë dhe fizikë, bëhet pas përfundimit të ciklit të arsimit fillor (AF), mbështetur në vullnetarizmin e nxënësve dhe të prindërve të tyre.
 - d) Krijimi i klasës së re të profilizuar në sport do të nisë nga klasa e VI-të, për vitin shkollor 2019-2020, për të vijuar në vitet në vazhdim deri në klassën e IX-të.
 - e) Klasa e profilizuar në sport, për çdo disiplinë sportive ka numrin e përgjithshëm të nxënësve (djem/vajza), jo më të vogël se 22.

- f) Klasa e profilizuar në sport krijohet në një disciplinë të vetme sportive për të gjithë nxënësit (djem/vajza), ose në dy disciplina të kombinuara (djemtë në një disciplinë, vajzat në disciplinën tjetër).
- g) Drejtorët e shkollave 9-vjeçare hartojnë ngarkesën mësimore për mësuesit e edukimit fizik, referuar bazës ligjore në fuqi.
- h) Drejtuesit e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, dhe/ose drejtorët e shkollave, lidhin marrëveshje me organizata sportive (federata, klube sportive etj.) për ecurinë dhe konsolidimin e klasës së profilizuar në sport, sipas disciplinave sportive.

I.3 ARSIMI I MESËM I LARTË

I.3.1 GJIMNAZET

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të ndjekin me përparësi:

1. Zbatimin e kurrikulës së re, bazuar në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës në gjimnaz (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në gjimnaz), IZHA, tetor 2016, në udhëzuesin për zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje në gjimnaz (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në gjimnaz), IZHA, maj 2018, si dhe në udhëzuesin kurrikular lëndorë në arsimin e mesëm të lartë (Material ndihmës për mësuesit dhe drejtuesit në arsimin e mesëm të lartë sipas profileve përkatëse), IZHA, 2018.
2. Zbatimin e planeve mësimore sipas pikës 2, të Shtojcës bashkëlidhur.
3. Përdorimin e portofoleve lëndorë për klasat 10, 11 dhe 12 për vlerësimin e nxënësve, bazuar në udhëzimin nr.14, datë 28.7 2016, “Për vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.
4. Përfshirjen e kurrikulës digitale dhe përdorimin e infrastrukturës digitale në shkollat e mesme dhe angazhimin e mësuesve në përfshirjen e kurrikulave digitale, për garantimin e zhvillimit të kompetencave TIK tek nxënësit.
5. Mbështetjen e zbatimit të programit “Edukimi, ndërgjegjësimi dhe reduktimi i kërkësës për drogë dhe substanca të tjera të rrezikshme”, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për punët e brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 7638, datë 16.4.2014.
6. Koordinimin, në zbatim të kontratës që MASR-ja ka me Komisionin Evropian për zbatimin e programit *e-Twinning*, program i Erasmus Plus për Arsim dhe Edukim, të veprimeve për angazhimin e shkollave, drejtuesve dhe mësuesve në veprimtaritë që mundëson ky program.
7. Në zbatim pikës 11 të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Romët dhe zgjerimin e tyre në BE: nga fjalët në veprime, nënshkruar nga kryeministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, institucionet arsimore të angazhohen për rritjen e shkallës së regjistrimit të romëve dhe përfundimit prej tyre të arsimit të mesëm në masën 50 për qind.

I.3.2 GJIMNAZET ME ORIENTIM GJUHËSOR

1. T'i zgjedhin vetë tekstet shkollore për lëndën e gjuhës së huaj, nëse ato që janë në katalogun 2019-2020, nuk përmbushin kërkesat kurrikulare të kësaj lënde.
2. Të punojnë me grupe në lëndën e gjuhës së huaj, në përputhje me udhëzimin nr.21, datë 23.7.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.
3. Të përdorin Portofolin Evropian të Gjuhëve 2008 si një mjet për vetëvlerësimin e nxënësit për aftësitë gjuhësore dhe vlerësimin me portofol.

I.3.3 SEKSIONET DYGYUHËSHE SHKOLLORE

1. ZVAP-të, të cilat kanë seksione dygjuhëshe, të zbatojnë:
 - a) Marrëveshjen nr.6045 prot., datë 13.6.2016, midis ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për punët e jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar të Republikës së Francës mbi “Bashkëpunimin në fushën e arsimit dygjuhësh”.
 - b) Marrëveshjet ekzistuese për seksionet dygjuhëshe, shqiptaro-italiane dhe shqiptaro-gjermane.
 - c) Planin mësimor për seksionin dygjuhësh shqiptaro-gjerman, miratuar me shkresën nr.7496 prot., datë 22.7.2016.
 - d) Planin mësimor për seksionin dygjuhësh shqiptaro-italian, miratuar me shkresën nr.7496 prot., datë 22.7.2016.
2. Drejtoritë e institucioneve arsimore të sigurojnë bashkëpunim dhe bashkërendim midis ekipeve lëndore të seksioneve dygjuhëshe dhe atyre të gjimnazave ku ato funksionojnë. ZVAP-të të ndjekin me përparsi regjistrimin e nxënësve në seksionet dygjuhëshe dhe të raportojnë në MASR deri me 10 shtator 2019 për ecurinë e tyre.

I.3.4 ZBATIMI I PORTOFOLIT EVROPIAN TË GJUHËVE (PEGJ):

1. Në mbështetje të “Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencës për Gjuhët”, si dhe të programeve lëndore të kurrikulës së re me kompetenca për gjuhët e huaja, mësuesit e gjuhëve të huaja të bazohen në Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ) për vlerësimin e nxënësve, si dhe të planifikojnë orë mësimore për të.
2. Modelet shqiptare të akredituara nga Këshilli i Evropës janë: No. 96.2008 për arsimin e mesëm dhe No. 106.2010 për arsimin bazë dhe modelet e regjistruara: Nr.2014 RO20, Nr.2014 RO22 dhe Nr.2014 RO23 për gjuhën italiane.
3. Përdorimi i PEGJ është i detyrueshëm për të gjithë nxënësit që zhvillojnë gjuhë të huaj. Nxënësit e klasës III të pajisen me PEGJ dhe ta përdorin atë deri në klasën V. Nxënësit e klasës VI të pajisen me PEGJ dhe ta përdorin atë deri në klasën IX. Nxënësit e klasës X të pajisen me PEGJ dhe ta përdorin atë deri në klasën XII.

I.3.5 ARSIMI PROFESIONAL (AP)

Zbatimi i skeletkurrikulave për drejtimet/profilet profesionale të Nivelit III të AP (Niveli IV i KSHK-së):

1. Për strukturën 2+1+1

Niveli III i AP të ofrohet vetëm me drejtime mësimore, pra nxënësit që kanë përfunduar Nivelin II të AP (klasa XII) në një nga profilet mësimore të një drejtimi të caktuar, të vijojnë Nivelin III të AP (klasa XIII) vetëm në drejtimin mësimor përkatës. P.sh. nxënësit e profileve “Shërbime motorike” dhe “Shërbime xhenerike”, klasa XII, të vijojnë shkollimin në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, klasa XIII. Kjo do të thotë që, nxënësit që përfunduan klasën XII, në profile të ndryshme të të njëjtë drejtim, mund të bashkohen në klasa të përbashkëta dhe të ndjekin drejtimin mësimor përkatës në klasën XIII.

2. Për strukturën 2+2

Niveli III i AP të vazhdojë me profile mësimore. Nxënësit që kanë përfunduar Nivelin I të AP (klasa XI) në një nga drejtimet mësimore, mund të vijojnë Nivelin III të AP (klasa XII-XIII) vetëm në një nga profilet mësimore të këtij drejtimi.

3. Për mënyrën e realizimit të moduleve praktike

Shkollat ta përgjedhin vetë mënyrën më optimale për të realizuar modulet e praktikave profesionale të detyruara dhe ato me zgjedhje të detyruar në të gjitha nivelet (të grupuara, të shpërndara, në mjediset e praktikave të shkollës, në biznese etj.).

Shkolla ka pavarësi të plotë në renditjen, orarin dhe vendin (shkollë apo biznes) e trajtimit të moduleve praktike.

Përgjedhja e modulit/moduleve me zgjedhje të detyruar (nga lista e moduleve të ofruar në skeletkurrikul) bëhet nga vetë shkolla, duke konsideruar:

- a) kërkosat e tregut rajonal të punës;
- b) kërkosat e nxënësve;
- c) mundësitet e shkollës për ta trajtuar modulin/modulet përkatëse.

4. Matura Shtetërore

Rregullorja e zhvillimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2020 përfshirë dhe Maturën Shtetërore Profesionale dhe udhëzimet përkatëse do të miratohen nga ministri përgjegjës për arsimin dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.

I.4 ARSIMI PARAUNIVERSITAR PRIVAT

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar:
 - a) Të mbajnë kontakte të vazhdueshme me të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar privat, t'i informojnë rregullisht për çdo ndryshim apo akt të ri ligjor dhe t'i ndihmojnë ato për realizimin e planeve dhe programeve mësimore si dhe të veprimtarive jashtëshkollore rajonale e kombëtare.
 - b) Të kërkojnë raportim për të dhënrat statistikore që lidhen me gjithë procesin mësimor, si: numrin e nxënësve të regjistruar në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, braktisjen, kalueshmérinë etj.
 - c) Të bëjnë vlerësimin e kritereve të ligjshmërisë për çdo institucion arsimor dhe të raportojnë në DPAP dhe në MASR.
2. Institucionet arsimore parauniversitare private:
 - a) Të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në fillim të vitit shkollor, numrin e nxënësve dhe listën e mësuesve, sipas statistikave të miratuar, certifikatën e regjistrimit në organin tatimor dhe planin vjetor të shkollës sipas formatit të parashikuar në DN 2013, të ndryshuar.
 - b) Për transferimin e nxënësve të zbatojnë nenin 90, të DN 2013, të ndryshuar si edhe udhëzimin nr.21 datë 9.7.2015, “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtim i arsimit profesional në gjimnaz”.
 - c) Të realizojnë detyrimet e tyre në përdorimin dhe ruajtjen e dokumentacionit (registra, amza, evidenca për lëvizjet e nxënësve, rregullore e brendshme e kopshtit/shkollës, dëftesa, kontrata me prindërit etj.), sipas udhëzimit nr.15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.
 - d) Institucioni arsimor parauniversitar privat mund ta ndërpresë veprimtarinë e tij arsimore vetëm në fund të vitit shkollor. Për mbylljen e veprimtarisë së tij arsimore duhet të njoftojë institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar (DRAP&ZVAP), MASR-në, QKB-në dhe të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e plotë në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës.
 - e) Institucionet arsimore parauniversitare private që funksionojnë në gjuhë të huaj, të bashkëpunojnë me institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar për njoftimin në kohë të maturantëve të cilët dëshirojnë të vijojnë studimet e larta në IAL-të e vendit për zbatimin e procedurave të përcaktuara nga Rregullorja e Maturës Shtetërore të vitit përkatës. Për maturantët që dëshirojnë të vijojnë studimet e larta jashtë vendit, të bashkëpunojnë me përfaqësítë e huaja të shtetit përkatës për njohjen e kritereve të aplikimeve në universitet e huaja.

I.5 REGJISTRIMI I NXËNËSVE DHE PAJISJA ME TEKSTE SHKOLLORE

1. Regjistrimet e nxënësve në shkollat e arsimit parauniversitar të fillojnë në datën 2.9.2019 dhe të mbyllen në datën 13.9.2019 për arsimin bazë dhe arsimin e mesém të lartë.
2. Drejtoritë e shkollave të afishojnë, në vend të dukshëm të shkollës, listën e teksteve shkollore, ku shënohen titulli, shtëpia botuese, çmimi i tekstit, për çdo klasë të shkollës, vendi ku do të shpërndahen tekstet si dhe periudha, sipas një grafiku për çdo klasë.
3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtuesit e shkollave dhe mësuesit të ndjekin me përgjegjësi:
4. procesin e shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore, në mënyrë që më 16 shtator të mos mbetet asnjë nxënës pa u pajisur me të gjitha tekstet shkollore;
5. procesin e pajisjes me tekste shkollore në përdorim falas për klasat I-V të arsimit fillor, si dhe pajisjen me tekste shkollore falas të të gjitha kategorive të përcaktuara në VKM-në përkatëse.
6. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të njoftojnë, zyrtarisht MASR-në për ecurinë e procesit të pajisjes së të gjithë nxënësve me tekste shkollore, me fokus kategoritë e veçanta, në përputhje me VKM-në nr.107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar dhe udhëzimin e përbashkët të ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe ministrit të Financave nr.51, datë 20.9.2013, “Për procedurat e përdorimit të fondeve të Buxhetit të Shtetit për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar.

I.6 VLERËSIMI I DREJTORIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR DHE I MËSUESIT, PLANI VJETOR

1. Titullarët e institucione arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtorët e institucioneve arsimore të zbatojnë procedurat e vlerësimit përkatësisht të drejtorëve/mësuesve, siç parashikohet në nenet 60 dhe 74, të DN 2013, të ndryshuara.
2. Plani vjetor i shkollës të hartohej e të miratohet sipas procedurave dhe formatit të përshkruar në nenin 67, të DN 2013, të ndryshuara dhe të jetë i zbatueshëm që në fillim të vitit shkollor.

I.7 FUNKSIONIMI I ORGANIZMAVE NË INSTITUCIONET ARSIMORE

Në çdo institucion arsimor t'i jepet përparësi ngritisë dhe funksionimit, sipas legjisacionit në fuqi, të organizmave, si:

1. bordi i institucionit arsimor;
2. qeveria e nxënësve;
3. këshilli i prindërve të institucionit arsimor;
4. këshillat e prindërve të klasave;
5. komisioni i disiplinës;
6. komisioni i etikës dhe sjelljes;
7. komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit;
8. komisioni i këshillimit të karrierës.

I.8 NDALIMI I PËRDORIMIT TË TELEFONIT CELULAR

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të marrin masa për zbatimin me përparësi të urdhrit nr.493 datë 30.7.2018, “Për mospërdorimin e telefonit celular gjatë procesit mësimor në shkolla”, dhe të udhëzimit nr.34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”, si nga mësuesit ashtu dhe nga nxënësit.
2. Masat për ndalimin e përdorimit të telefonit celular të pasqyrohen në rregulloren e brendshme që hartohet në bashkëpunim me organizmat e institucionit arsimor.

KREU II POLITIKA, STRATEGJI, MARRËVESHJE

II.1 REDUKTIMI I BRAKTISJES SHKOLLORE

1. Për reduktimin e braktisjes shkollore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të zbatojnë me përgjegjësi Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr.7522 prot., datë 12.7.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës shkollore”, ndërmjet MASR-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Ministrisë së Brendshme (MB).
2. Një nxënës i arsimit të detyruar konsiderohet:
 - a) braktisës, nëse është i regjistruar në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor rezulton i paklasifikuar (mbetës) për shkak të mungesave;
 - b) potencialisht braktisës, nëse është regjistruar në fillim të vitit shkollor dhe në fillim të javës së tretë të tetorit raportohet nga shkolla si i paparaqitur;
 - c) jobraktisës, nëse përmbush një prej kushteve përjashtuese: fatkeqësitetë familjare, kontrolllet mjekësore, sëmundje që zgjat shumë ose që shkakton mungesa të rregullta (dokumentuar me raport mjekësor), transferimi në një shkollë tjetër brenda vendit (i dokumentuar), migrimi jashtë vendit (i dokumentuar), vdekja.
3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të:
 - a) monitorojnë shkollat lidhur me raportimin real të nxënësve braktisës, potencial për braktisje dhe fëmijëve jashtë sistemit arsimor;
 - b) koordinojnë bashkëpunimin ndërmjet Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe institucioneve të shoqërisë civile për zgjidhjen e problemeve të nxënësve braktisës dhe të fëmijëve në situatë rruge;

- c) ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve të ngujuar dhe zbatimin e procedurave të ndjekjes së arsimit bazë, sipas udhëzimit përkatës, për nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë;
 - d) raportojnë në MASR dy herë në vit (në fund të muajit janar dhe në fund të vitiit shkollor) punën e bërë për reduktimin e braktisjes shkollore.
 - e) plotësojnë sistemin “Romalb” për të gjithë treguesit e formularit online, brenda afatit që do të caktojë MSHMS-ja, si administratore e këtij sistemi.
4. Shkollat, të:
- a) identifikojnë dhe të raportojnë me përgjegjësi në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar nxënësit braktisë apo në rrezik braktisjeje;
 - b) trajtojnë rastet e nxënësve potencialisht braktisës për të siguruar frekuentimin e rregullt, bazuar në metodologjinë për identifikimin dhe riintegrimin në shkollë të fëmijëve në rrezik braktisjeje, të zhvilluar nga UNICEF dhe miratuar nga MASR (<http://izha.edu.al/new/2017/03/20/manuali-i-braktisjes-se-shkolles-2/>);
 - c) monitorojnë çdo lëvizje dhe transferim nga një shkollë në tjetër, si dhe çdo migrim jashtë vendit, përmes një bashkërendimi më të mirë ndërinstitucional, për të shmangur çdo rast të braktisjes së shkollës;
 - d) njoftojnë institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar kur nxënësi kamunguar në shkollë më shumë se 10 ditë pa arsy.

II.2 SHËRBIMI PSIKO-SOCIAL (SHPS)

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të:
- a) të marrin masat për funksionimin e shërbimit psiko-social në zbatim të urdhrit nr.344, datë 19.8.2013, “Për ngritjen e Njësisë së Shërbimit Psiko-social”, të ndryshuar, si dhe të informojnë Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR, brenda datës 13 shtator 2019;
 - b) të monitorojnë realizimin e planit të punës së njësive të SHPS-së dhe të raportojnë në MASR në janar 2020 dhe në qershor 2020.

II.3 ZBATIMI I STRATEGJIVE NDËRSEKTORIALE DHE PLANEVE KOMBËTARE TË VEPRIMIT

1. Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në MASR, DPAP-ja dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar në bazë të planit të veprimit për zbatimin e secilës strategji kombëtare ndërministrore, të:
- a) caktojnë personat përgjegjës;
 - b) hartojnë plane pune vjetore me detyra dhe afate konkrete;
 - c) monitorojnë realizimin e veprimtarive;
 - d) raportojnë rregullisht për përbushjen e detyrimeve që lindin nga këto strategji.

2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të raportojnë në DPAP dhe MASR, në fund të muajit janar dhe në fund të vitit shkollor, për problemet që lidhen me zbatimin e strategjive dhe të planeve kombëtare të mëposhtme:

- a) **Plani Kombëtar i Veprimit për Integrinë e Romëve dhe Egjiptianëve, 2016-2020.** Me përparësi të ndiqen:
 - i. ofrimi i arsimit cilësor dhe përfshirës për romët dhe egjiptianët dhe promovimi i dialogut ndërkulturor;
 - ii. rritja e numrit të romëve dhe egjiptianëve që përfundojnë të gjitha nivelet e arsimit;
 - iii. zhvillimi i një komuniteti shkollor që promovon dialogun ndërkulturor dhe mirëkuptimin e përbashkët;
 - iv. vlerësimi dhe promovimi i njohjes së identitetit rom dhe atij egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.
- b) **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020.** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e institacioneve arsimore:
 - i. të promovojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në shkollë dhe më gjerë;
 - ii. të punojnë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës në institucionet arsimore.
- c) **Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (2016-2020).** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e institacioneve arsimore, të:
 - i. ndjekin me përparësi arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) dhe të krijojnë kushte për integrinë e tyre në kopshte e shkolla;
 - ii. punojnë me përgjegjësi që nxënësit me AK të vlerësohen në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar përkatëse, nga komisionet multidisiplinare dhe, në zbatim të rekomandimit të dhënë nga komisioni, të trajtohen nga mësuesit, mësuesi ndihmës dhe psikologu i shkollës me plan edukativ individual;
 - iii. zbatim të Memorandumit mes MASR dhe World Vision Albania, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar që mbulojnë bashkitë Dibër, Shkodër, Lezhë, Kurbin, Kamzë, Durrës, Elbasan, Përrenjas dhe Korçë të mbështesin funksionimin në 16 shkolla të arsimit bazë të "Hapësirave zhvillimore", si një qasje sistemike e ofrimit të shërbimit për fëmijët me aftësi të kufizuara/ nevoja të veçanta dhe për çdo fëmije në shkolla, si dhe të marrin masa për të siguruar tre dite të javës prezencën e psikologut dhe të punonjësit social pranë këtyre shkollave.
- d) **Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, drejtoritë dhe stafet e shkollave si dhe njësitë e shërbimit psiko-social, të:
 - i. marrin masa për edukimin kundër trafikimit të nxënësve, përmes trajtimit të moduleve të veçanta në kurrikulën me zgjedhje të lirë dhe veprimtarive të ndryshme;

- ii. zbatojnë Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) për identifikimin dhe referimin e viktimateve të mundshme të trafikut si dhe të arsimojnë me përparësi, sipas akteve ligjore në fuqi, viktimat e trafikut, të identifikuara dhe të trajtuar në qendrat rezidenciale;
 - iii. marrin masa për të zhvilluar veprimtari dhe fushata informuese dhe edukative në nivel shkolle dhe njësie arsimore vendore, përgjatë muajit tetor 2019, si muaji i antitrafikut të qenieve njerëzore.
- e) **Plani Strategjik i Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017–2020.** Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e institucioneve arsimore, të:
- i. realizojnë trajnime me mësues, nxënës dhe me komunitetin e prindërve për ndërgjegjësimin lidhur me rrezikun dhe luftën për parandalimin e përdorimit të drogës dhe kanabisit në shkollë dhe në komunitet;
 - ii. realizojnë aktivitetet e ekstrakurrikulare në të gjitha klasat e arsimit parauniversitar.
- f) **Strategja Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI në Republikën e Shqipërisë 2016-2020.** Për këtë:
- i. institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e institucioneve arsimore të programojnë dhe të realizojnë trajnime me mësues dhe me komunitetin e prindërve dhe të caktojnë një mësues përgjegjës në çdo institucion arsimor që të mbulojë dhe të koordinojë veprimtaritë;
 - ii. institucionet arsimore, në zhvillimin e edukimit për karrierën, të trajtojnë me përparësi mënjanimin e stereotipave gjinorë dhe të diskriminimit si pasojë e orientimit seksual, në përzgjedhjen e degëve dhe drejtimeve të studimit të mëtejshëm;
 - iii. institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të marrin masa që personi përgjegjës për barazinë gjinore të ndjekë me përparësi dhe të koordinojë planifikimin e veprimtarive ndërgjegjësuese në bashkëpunim me punonjësit e shërbimit psiko-social.
- g) **Plani i Veprimit të Programit Kombëtar për Edukimin Mjedisor në shkollat e arsimit bazë në Shqipëri.** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të:
- i. hartojnë planin e veprimtarive në zbatim të tij dhe ta dërgojnë atë në MASR brenda muajit tetor 2019;
 - ii. përcaktojnë një koordinator për ndjekjen dhe zbatimin e këtij plani.
- h) **Plani i veprimit për Sigurinë e Fëmijëve në Internet në shkollat e arsimit parauniversitar.** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të:
- i. koordinojnë veprimet për realizimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe përdorimin e mjeteve për informimin e fëmijëve mbi abuzimin online, mbrojtjen dhe raportimin e krimeve.
 - ii. koordinojnë veprimet për trajnimin e mësuesve për çështjet e informimit dhe edukimit.
- i) **Plani Kombëtar për Ushqimin dhe Ushqyerjen.** Për këtë:
- i. institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të planifikojnë veprimtari gjithëvetore në zbatim të programit “Për një ushqyerje të shëndetshme”;

- ii. për zbatimin e planit të përdoret paketa didaktike e përgatitur nga IZHA dhe Instituti i Shëndetit Publik.
- j) **Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.4481 prot., datë 25.4.2018, ndërmjet MASR-së dhe Shoqatës Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë.** Për zbatimin e kësaj marrëveshje çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të identifikojë fëmijët me probleme të të dëgjuarit, të cilët nuk frekuentojnë shkollën, si dhe të marrë masa përfshirjen e tyre në arsimin bazë, të zakonshëm apo special, në varësi të nivelit të paaftësisë.
- k) **Memorandumi i Bashkëpunimit datë 28.8.2014, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Korpusit të Paqes të Shteteve të Bashkuara në Shqipëri.** Për këtë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të informojnë institucionet arsimore që ato të marrin masat si vijon:
 - i. të përfshijnë vullnetarin/en në takimet e organizuara në shkollë për procesin e bashkëmësimdhënies dhe të projekteve të ndryshme në interes të shkollës;
 - ii. të mbështesin mësuesit të marrin pjesë në trajnimet që zhvillon/sponsorizon Korpusi i Paqes.
 - iii. të përfshijnë vullnetarin/en në organizimin dhe zbatimin e veprimitarive dhe të projekteve të ndryshme në shkollë dhe komunitet;
 - iv. të mbështesin vullnetarin/en në zbatimin e nismës për të zhvilluar aftësinë në gjuhën angleze të mësuesve të lëndëve të tjera, sipas kurrikulës dhe planeve mësimore të zhvilluara nga MASR, ASCAP dhe Korpusi i Paqes.
- l) **Marrëveshja e Bashkëpunimit nr.4661/1 prot., datë 18.6.2015, “Për implementimin e projektit “Mësime të shahut në shkollë”, ndërmjet MAS-it, Federatës Evropiane të Shahut dhe Federatës Shqiptare të Shahut.**
- m) **Marrëveshja e MASR me Agjencinë Ekzekutive për Arsimin, Audiovizive dhe Kulturën e Komisionit Evropian, AGREEMENT NUMBER —2019-0141 / 001-001.**
- n) **Memorandumi i Bashkëpunimit nr.363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr.600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.** Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të koordinojë veprimitaritë kulturore, artistike, figurative që mundëson ky memorandum.
- o) **Memorandumi i Mirëkuptimit me nr.2436 prot, datë 28.2.2019, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Këshillit Britanik në Shqipëri për zbatimin e projektit “Shkollat e shekullit 21”.** Çdo institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar të koordinojë veprimitaritë që mundëson ky memorandum, duke organizuar dhe zhvilluar trajnimet me mësuesit dhe drejtuesit e shkollave të arsimit bazë për aftësitë e të menduarit kritik, zgjidhjes problemore dhe kodimit, për përdorimin e pajisjeve *micro bit* dhe mënyrën e integrimit të këtyre aftësive në praktikë, në klasë.

KREU III
VEPRIMTARI SHKOLLORE DHE JASHTËSHKOLLORE, VETËVLERËSIMI

Në zbatim të nenit 9, të kreut III, të DN 2013, të ndryshuara, për veprimtaritë shkollore dhe jashtëshkollore si dhe veprimtari të tjera plotësuese, pa cenuar për asnjë nxënës orët mësimore të parashikuara në programet lëndore, të ndiqen me përparësi nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtori të e institacioneve arsimore:

- 1. Konsolidimi i shkollave qendra komunitare (SHQK), bazuar në Standardet e Shkollës si Qendër Komunitare, miratuar me shkresën nr.1794 prot., datë 13.3.2013 dhe udhëzuesin për Shkollat Qendra Komunitare, titor 2014, në këto aspekte:**
 - a) të konsolidohet SHQK-ja duke vlerësuar shkollat për përbushjen e standardeve dhe kritereve të përcaktuara për SHQK-në, si dhe përcaktimin e qartë të fushave në bazë të vlerësimit të bërë përmes portalit të SHQK;
 - b) shkollat, pjesë e programeve të bashkëpunimit me partnerët Save the Children, World Vision, UNICEF, UNDP, të vijojnë të jenë pjesë e SHQK-së dhe të bashkëpunohet për përbushjen e angazhimeve dypalëshe dhe të projekteve në proces.
- 2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të:**
 - a) vlerësojnë shkollat qendër komunitare në përputhje me standardet;
 - b) marrin masat e nevojshme për trajnimin dhe rritjen e kapaciteteve të mësuesve koordinatorë, strukturave të shkollës, grupimeve nga komuniteti, në bashkëpunim me ASCAP-in dhe partnerët;
 - c) promovojnë praktikat më të mira të SHQK-ve dhe të shkëmbajnë përvojat mes shkollave;
 - d) promovojnë dhe mbështesin skemën e mini-granteve të ofruara nga World Vision Albania për shkollat e arsimit para universitar me qëllim angazhimin e komunitetit për zbatimin e standardeve cilësore dhe aksesueshmërisë në shkollat SHQK sipas standardeve të fushës V: Gjithëpërfshirja dhe diversiteti;
 - e) promovojnë në ato shkolla ku World Vision Albania zbaton modelin “Impact Club”, ndarjen e njohurive dhe organizimin e aktiviteteve gjatë orëve të lira, me qëllim rritjen e kompetencave të fëmijëve dhe adoleshentëve për promovimin e qytetarisë aktive;
 - f) marrin masat për menaxhimin sa më efektiv të 10 orëve javore të planifikuara për SHQK. Sjellim në vëmendje që:
 - i. 10 orët javore të planifikuara për SHQK-në të mos përdoren vetëm për plotësimin e ngarkesës mësimore lëndore të mësuesit, por për punën e tij përtej procesit mësimor, në bashkëpunim me strukturat e shkollave, komunitetin dhe ato lokale;
 - ii. angazhimi i mësuesve në SHQK, kur është e mundur, të jetë jo më shumë se 2 orë javore pjesë e ngarkesës së tyre mësimore;
 - iii. të shmanget rastet kur e gjithë ngarkesa prej 10 orësh, e planifikuar për SHQK, ose kur shumica e këtyre orëve i jepet vetëm një mësuesi. Drejtuesit e shkollës e plotësojnë normën e tyre mësimore vetëm me lëndët e profilit të diplomës që zotërojnë.

- g) monitorojnë zbatimin e rekomandimeve të mësipërme dhe të raportojnë në DPAP për planifikimin e orëve të SHQK-së deri më 30 tetor 2019;
- h) Deri më 24 korrik 2020 për të gjithë procesin e zbatimit të planit të SHQK-së (Raport vjetor). Kalendar i punës për SHQK për vitin shkollor 2019-2020 të përbajë:
 - i. vlerësimin e fushave të SHQK, standardeve të shkollës, si dhe hedhja në portalin e SHQK-së të të dhënave të vlerësimit të standardeve (të finalizohet në fund të muajit shtator 2019);
 - ii. trajnimi i strukturave të shkollës në kuadër të SHQK (të realizohet në muajin tetor 2019);
 - iii. plani i shkollës qendër komunitare të fokusohet në një ose në dy nga pesë fushat e SHQK-së, si dhe të hidhet në portal deri në fund të muajit dhjetor 2019.

3. Karta e Performancës e viti shkollor 2018-2019 dhe për vitin shkollor 2019-2020.

a) Për vitin shkollor 2018-2019:

- i. Shkollat do të llogarisin edhe ndryshimet në vlerë për treguesit e pasqyruar një vit më parë.
- ii. Në dërgimin e të dhënave që burojnë nga shkolla, të sqarohet edhe procedura e përpunimit të të dhënave siç është përcaktuar në “Udhëzuesin për Kartën e Performancës së Shkollës”.
- iii. Shkollat të renditen në nivel rajonal edhe për rezultatet e arritura në vlerësimin e kryer në klasat e pesta.
- iv. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar mund të vendosin të kenë tregues rajonalë ose jo (p.sh., të dhëna për lëndët me zgjedhje, arrijet e nxënësve me AK etj.).
- v. Çdo shkollë në arsimin parauniversitar, deri më 3.9.2019, të plotësojë Kartën e Performancës së Shkollës për vitin shkollor 2018-2019, si dhe ta bëjë atë publike për prindërit dhe komunitetin.
- vi. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të verifikojnë të dhënat e dërguara nga shkollat deri më 10.9.2019.
- vii. Në fund të muajit shtator 2019, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të shpallin shkollat e suksesshme në zbatim të pikës 4, nenit 126, të DN, 2013, të ndryshuara.

b) Për vitin shkollor 2019-2020:

- i. Çdo shkollë e arsimit parauniversitar të hartojë Kartën e Performancës së Shkollës, me treguesit e përzgjedhur.
- ii. Shkollat të llogarisin edhe ndryshimin në vlerë për treguesit e pasqyruar në Kartën e Performancës së viti paraardhës.

4. “Stop dhunës në institucionet arsimore”.

Njësitë arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtore të institucioneve arsimore të marrin masa për:

- a) Planifikimin vjetor të veprimtarive ndërgjegjësuese me fokus minimizimin e dhunës në institucionet arsimore.
- b) Ngritjen e këndit “Stop dhunës në shkollë”.
- c) Monitorimin dhe përmirësimin e punës të komisioneve të etikës për trajtimin e rasteve të çdo lloji të dhunës në institucionet arsimore.

- d) Raportimin sipas formateve të përcaktuara, në DPAP të rasteve të dhunës në institucionet arsimore, të trajtuar nga komisionet e etikës, si dhe raportin narrativ për punën e bërë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve, brenda datës 30 maj 2020.
- e) DPAP harton raportin përbledhës dhe e dërgon në MASR (në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë), brenda datës 1 korrik 2020.

5. Lufta kundër bullizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor shqiptar.

Në këtë kuadër, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të marrin masat si vijon:

- a) të ngrihen ekipet “*antibulling*”, si dhe të hartohen planet vjetore kundër ekstremizmit;
- b) të hartohet plani i veprimeve i mbështetur në dokumentet e hartuara nga projekti i përbashkët ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, zbatuar në vitin paraardhës në 21 shkolla të mesme;
- c) të shtrihet përvoja e fituar nga projekti në të gjitha shkollat në shkallë ZVAP-je;
- d) të koordinohen veprimtaritë ndërgjegjësuese ndërmjet shkollave, ku rolin drejtues për organizimin e aktiviteteve ta marrin shkollat që ishin pjesë e projektit;
- e) të planifikohet sipas një kalendarit organizimi i veprimtarive ndërgjegjësuese të datës 21 Nëntor 2019, ”Ditës kombëtare kundër bullizmit”;
- f) të angazhohen mësuesit e trajnuar për luftën kundër bullizmit për ndarjen e njohurive dhe përvojave në shkollat e tjera, duke përdorur modulin e akredituar me vendimin nr.20, datë 19.12.2017 nga KAPT “Parandalimi dhe trajtimi i bullizmit, dhunës dhe ekstremizmit në shkolla”;
- g) shërbimi Psiko-Social në secilën shkollë të bashkëpunojë me ekipet antibulling për monitorimin dhe përmirësimin e sistemeve të referimit për adresimin e rasteve të bullizmit.

6. Veprimtari edukative, shkencore, artistike, kulturore e sportive gjithëvetore në shkollë dhe jashtë procesit mësimor.

Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të planifikojnë, të organizojnë dhe të realizojnë veprimtari me përfshirjen e të gjithë nxënësve, si më poshtë:

- a) Kampionati Kombëtar i Shahut për arsimin 9-vjeçar, në bashkëpunimin me Federatën Shqiptare të Shahut. Faza e parë të zhvillohet në bazë shkolle në muajin dhjetor, faza e dytë në bazë qarku në muajin shkurt dhe finalja në mars-prill.
- b) Java Olimpike (prill-maj).
- c) Olimpiadat kombëtare që zhvillohen në datat e përcaktuara në udhëzuesin vjetor të miratuar nga MASR.
- d) Dita Evropiane e Gjuhëve, 26 shtator 2019.
- e) Dita ndërkombëtare e të drejtave të fëmijëve, 20 nëntor 2019
- f) Dita e luftës kundër bullizmit, 21 nëntor 2019.
- g) Përkujtimi i Holokaustit dhe i krimeve kundër njerëzimit, 27 janar 2020.

- h) Dita Botërore e Gjuhës Amtare, 21 shkurt 2020.
- i) Dita Ndërkontaktuale kushtuar Sportit për Zhvillim e Paqe, 6 prill 2020.
- j) Dita Ndërkontaktuale e Romëve, 8 prill 2020.
- k) Dita Botërore e Librit, 23 prill 2020.
- l) Dita Ndërkontaktuale e-twinning, 7 maj 2020.
- m) Dita kundër Shfrytëzimit të Punës së Fëmijëve, 12 qershor 2020.
- n) Dita Evropiane e Kujtesës për të gjitha viktimat e regjimeve totalitare, 23 gusht 2020.
- o) Kalendar i Ditëve të Evropës dhe veprimtaritë gjithëjetore për njohjen e institucioneve të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.
- p) Konkurset në nivel institucional arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar me tematikë “Të njohim Evropën”.
- q) Java Evropiane e lëvizjes “Now we move”.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, për zbatimin e këtij udhëzimi.
2. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të marrim masat e duhura që ky udhëzim të shpërndahet në çdo institucion arsimor dhe me përbajtjen e tij të njihet çdo punonjës i arsimit.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



SHTOJCA-PLANET MËSIMORE

1. ARSIMI BAZÉ

Në zbatim të planit mësimor të arsimit bazë, shkollat kanë lirinë dhe fleksibilitetin të organizojnë orët mësimore për secilën lëndë. Në varësi të specifikave të lëndës dhe të mundësive të shkollës, shkollat mund të organizojnë orët mësimore të lëndëve duke zhvilluar për një lënde 2 (dy) orë mësimore të njëpasnjëshme ($45' + 45'$) ose orë të veçanta ($45'$). Sugerojmë që lëndët, që në planin mësimor janë planifikuar me 1 orë në javë, të zhvillohen me këtë mënyrë organizimi, pra çdo javë.

a) Në shkollën speciale "Luigj Gurakuqi" do të zbatohet plani mësimor si më poshtë:

Nr.	Lëndët	KLASAT						
		I	II	III	IV	V	VI	VII
1	Gjuhë amtare; Abetare, komunikim, elemente shkrimi, ushtrim të folurit	10	10	10	10	10	4	4
2	Matematikë dhe zhvillimi logjik	5	5	5	5	5	3	3
3	Punë dore dhe art	3	3	3	3	2	2	2
4	Edukim shoqëror	2	2	2	2	2	2	2
5	Edukim shëndetësor dhe vëtëshërbim	2	2	2	2	2	2	2
6	Edukim fizik	3	3	3	3	3	3	3
7	Edukim muzikor dhe muzikoterapi	2	2	2	2	2	2	2
8	Terapi të folurit me seancat individuale	2	2	2	2	2	2	2
9	Orientim dhe njoftje me mjesisë	1	1	1	1	1	1	1
10	Mësim pure	-	-	-	-	9	9	9
Gjithsej orët/javë:		30						

b) Në klasat I-IX të shkollave të pakicave kombëtare do të zbatohet plani mësimor si më poshtë:

Nr.	FUSHAT/LËNDËT	KLASAT							IX
		I	II	III	IV	V	VI	VII	
1.	Gjuhët dhe komunikimi	8/9	11	12	11	11	10	11	10
1.1.	Gjuhë amtare (grke/makedonase)	8/7	6	5	4	4	4	4	3
1.2.	Gjuhë shqipe	0/2	5	5	5	5	4	4	5
1.3.	Gjuhë e huaj			2	2	2	2	2	2
2.	Matematikë	4	4	4	4	4	4	4	4
3.	Shkencat e natyrës	1	1	1	2	2	2	4	6
3.1.	Dituri natyre	1	1	1	2	2	-	-	-
3.2.	Fizikë						1	2	2
3.3.	Kimi							2	2
3.4.	Biologji						1	2	2

4.	Shoqëria dhe mjedis	1	1	1	2	2	3	5	6	6
4.1.	Gjeografi						1	2	2	2
4.2.	Edukum pér shoqërinë	1	1							-
4.3.	Qytetari			1	1	1	1	1	1	1
4.4.	Histori		1						2	2
4.5.	Histori e Greqisë/Histori e Maqedonisë (ish-RJM)									1
4.6.	Gjeografi e Greqisë/Gjeografi e Maqedonisë (ish-RJM)									1
5.	Arte	2	2/3	3	2	2/3	2	2	2	1
5.1.	Muzikë	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.2.	Art pamor	1	1	1	1	1	1	1	1	1
5.3.	Kërcim									
5.4.	Teatër	0/1	1							
6.	Edukimi fizik, sporti dhe shëndeti	2	2	2	2	2	2	2	2	2
7.	Teknologji dhe TIK	i	i	i	2	2	2	1	1	1
7.1.	TIK									
7.2.	Aftësim teknologjik praktik									
8.	Kurrikula me zgjedhje	1	1	2	2	2	2	2	2	2
	SHUMA (orë/javë)	19/20	22/23	25	27	27/28	26	29	31	30

- c) Në shkollën koreografike, pér arsimin bazë do të zbatohet: “Plani mësimor pér arsimin bazë, pér shkollën Koreografike për klasat 4-9”, i miratuar me shkresën nr.9176/2 prot., datë 21.09.2018.
- d) Në shkollat artistike, pér arsimin bazë do të zbatohet: “Plani mësimor i arsimit bazë, pér shkollat artistike, viti shkollor 2018-2019” i miratuar me shkresën nr. 9176/3 prot., datë 21.09.2018.
- e) Në institucionet e paraburgimit dhe ato të vuajtjes së dënimt do të zbatohet plani mësimor pér arsimimin e individëve të mos hënë shkollore, i miratuar me Urdhrin nr. 5704 prot., datë 28.07.2015.

2. ARSIMI I MESËM I LARTË

Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, gjimnaz, të arsimit të mesëm të orientuar dhe të arsimit të mesëm profesional do të zbatohen planet mësimore si më poshtë:

- Plani mësimor i gjimnazit, kurrikula bërthamë dhe me zgjedhje, miratuar me urdhrin nr.12789 prot., datë 28.12.2017;

PLANI MËSIMOR I GJIMNAZIT

Nr.	Fushat/Lëndët	Klasat				12
		10	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	
1.	Gjuhët dhe komunikimi	7	252	7	252	7
1.1	Gjuhë shqipe	2	72	2	72	2
1.2	Letërsi	2	72	2	72	2
1.3	Gjuhë e huaj e parë	3	108	3	108	3
2.	Matematikë	4	144	4	144	4(B) ¹ ose 6 (A+B)
3.	Shkencat e natyrës	6	216	6	216	-
3.1	Fizikë	2	72	2	72	-
3.2	Kimi	2	72	2	72	-
3.3	Biologji	2	72	2	72	-
4.	Shoqëria dhe mjedisi	6	216	6	216	3
4.1	Shkenca sociale (Qytetari ² , Filozofi ³)	2	72	2	72	-
4.2	Histori	2	72	2	72	-
4.3	Geografi	2	72	2	72	-
4.4	Ekonomi	-	-	-	-	-
5	Teknologji dhe TIK	2	72	1	36	-
5.1	TIK	2	72	1	36	-
6	Edukimi fizik, sporte dhe shëndetë	3	108	3	108	3
	KURRIKULA BËRTHAMË (SHUMA)	28	1008	27	972	17-19
	KURRIKULA ME ZGJEDHJE	2	72	3	108	13-11
	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE⁴	02	0.72	0.2	0.72	0-2
	TOTALI (Nr. i orëve javore gjithsej)⁵	30-32	1080-1152	30-32	1080-1152	30-32
						1020-1088

¹ Në klasën e 12-të, përlendën “Matematikë”, nxënësit mund të zgjedhin brenda kurrikulës bërthamë programet sipas niveleve:

² A+B (ku A është niveli i avancuar përmban edhe B (bërthamë) dhe B (ku B është niveli bërthamë).

³ Qytetaria zhvillohet në klasën e 10-të.

⁴ Filozofia zhvillohet në klasën e 11-të.

⁵ Brenda hapësirës së kurrikulës në bazë shkollë zhvillohet dhe “Shërbimi komunitar”. Shërbimi komunitar është i detyruar të kryhet në 18 orë, në klasën e 10-të dhe/ose në klasën e 11-të. Orët e tjera të kurrikulës në bazë shkolle nuk janë të detyruara për nxënësit, ato i mundësojnë shkollës zbatimin e kurrikulës lidhur me projekte ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore. Kurrikula në bazë shkolle nuk vlerësohet me notë.

⁶ Java mësimore ka 30-32 orë mësimore. 30 orë në javë janë përdorura për nxënësin dhe shkolla i plotëson me kurrikulën bërthamë dhe kurrikulën me zgjedhje. 2 orët e kurrikulës me bazë shkolle janë fakultative që i mundësojnë nxënësit zhvillimin e moduleve/ projekteve ndërkurrikulare/veprimtari të tjera shkollore. Nxënësi ka detrimin të zhvillojë 30 orë në javë për secilin vit shkollor, si dhe 18 orët e shërbimit komunitar. Në kombinimin e lëndëve me zgjedhje, shkolla duhet të bëjë kujdes të mos tejkalojë totalin 11-13 orë të kurrikulës me zgjedhje.

KURRIKULA ME ZGJEDHJE

Nr.	FUSHAT/LËNDËT	KLASAT					
		10	Orë javore	Orë vjetore	Orë javore	Orë vjetore	12
1.	Gjuhët dne komunikimi	2	72	2	72	4	136
1.2	Letërsi	-	-	-	-	2	68
1.3	Gjuhë e huaj e dytë	2	72	2	72	2	68
2.	Matematikë	-	-	-	-	2(A)	68(A)
3.	Shkencat e natyrës	-	-	-	-	12	408
3.1	Fizikë	-	-	-	-	4	136
3.2	Kimi	-	-	-	-	4	136
3.3	Biologjji	-	-	-	-	4	136
4.	Shoqëria dhe mjedis	-	-	-	-	12	408
4.1	Shkenca sociale (Sociologji, Psikologjji ⁶)	-	-	-	-	2+2	68+68
4.2	Histori	-	-	-	-	4	136
4.3	Gjeografi	-	-	-	-	4	136
5	Arte⁷ (Teatër, Muzikë, Art pamor)	2	72	2	72	2	68
6	Teknologji dhe TIK	-	-	1	36	4	136
6.1	TIK	-	-	1	36	2	68
6.2	Teknologji	-	-	-	-	2	68
7	Edukimi fizik, sporte dhe shëndeti	1	36	1	36	1	34
8	Module kurrikulare⁸	2	72	2	72	Max 8	Max 272

Shënim. Në rastet kur në kurrikulën me zgjedhje në klasën e 12-të nxënësi zgjedh të zhvillojë lëndë të cilat janë me numër qift orësh, ai mund të zhvillojë dhe deri në 31 orë mësimore në javë, të vlerësuara me notë.

- Për shkencat sociale, si pjesë e kurrikulës me zgjedhje në klasën e 12-të, nxënësi mund të zgjedh të zhvillojë njëren prej lëndëve (Sociologji/Psikologji) ose të dyja së bashku (Sociologji dhe Psikologji).
- Fusha “Arte” përbëhet nga tri lëndë (Teatër, Muzikë, Art pamor), të cilat mund të ofrohen si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, të pavarura nga njëra-tjetra.

- Modület kurrikulare, si pjesë e kurrikulës me zgjedhje, përzgjidhen njësoj si lëndët e tjera të kurrikulës me zgjedhje. Në kurrikulën me zgjedhje, shkolla ofron module vetëm nga lista e moduleve kurrikulare të publikuara në faqen zyrtare të MASR-së dhe ASCAP-it. Kjo listë përfshin module profesionale që zhvillojnë tek nxënësi aftësi të nevojshme për tregun e punës dhe module që zhvillojnë tema ndërkurrikulare.

Në zbatim të planit mësimor të gjimnazit, shkollat kanë lirinë dhe fleksibilitetin të organizojnë orët mësimore për se cilëën lëndë. Në varësi të specifikave të lëndës dhe të mundësive të shkollës, shkollat mund të organizojnë mësimin e lëndës me 2 (dy) orë mësimore të njëpasnjëshme (45'+45') ose orë të veçanta (45'). Sugjerojmë që lëndët, të cilat në planin mësimor janë planifikuar me 1 orë në javë, të zhvillohen me këtë mënyrë organizimi, pra çdo javë.

Në shkollat e arsimit të mesëm të lartë, të arsimit të mesëm të orientuar artistik, sportiv dhe gjuhësor do të zbatohen planet mësimore si më poshtë:

1. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën Koreografike, i miratuar me nr.9176/1 prot., datë 21.9.2018.
2. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën (Artistike), i miratuar me nr.9176/3 prot., datë 21.9.2018.
3. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën (Artistike), i miratuar me nr.9176/5 prot., datë 21.9.2018.
4. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën (Artistike), i miratuar me nr.9176/6 prot., datë 21.9.2018.
5. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar për shkollën (Artistike), i miratuar me nr.9176/7 prot., datë 21.9.2018.
6. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (Artistike), miratuar me nr.5422 prot., datë 26.5.2016 (zhvillohet edhe për specialitetin fotograf).
7. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (Sportive), miratuar me nr.5418 prot., datë 26.5.2016.
8. Plani mësimor për arsimin e mesëm të orientuar (Sportive), miratuar me nr.5418/1 prot., datë 26.5.2016.
9. Plani mësimor arsimi i mesëm i orientuar (Shkollat e gjuhëve të huaja), miratuar me nr.5415 prot., datë 26.5.2016, shoqëruar me shkresën e ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.4595 prot., datë 5.5.2017.
10. Në shkollat e arsimit të mesëm profesional planet mësimore për të gjitha drejtimet/profilat mësimore sipas niveleve 2-4 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, pjesë e skeletkurrikulave përkatëse janë publikuar në linkun e faqes zyrtare të internetit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK): <http://www.akafp.gov.al/dokument-kurrikulare/skelet-kurrikula-te-arsimit-te-mesem-profesional/>.

GJIMNAZI ME KOHË TË PJESSHME

Në gjimnazin me kohë të pjesshme do të zbatohet plani mësimor i gjimmazit me kohë të pjesshme, miratuar me nr.7380 prot., datë 20.7.2016.